



Pranimi / Pritjeja Prilipi / Protokol Received / Delivery	28.04.2023	3	viti god year
Organ / Shërbim Organ / Jednica Org / Unit	Nr. Prot Pr. / Prot No	Shërbim Prilipi Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKM/SHOK	3964/2023		115



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.422/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj Demi-anëtarë, me Flakron Gashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.422/2023 të datës 27.02.2023 të parashtruar nga ankuesi kundër vlerësimit të rezultateve të punës për vitin 2022, në çështjen juridike “vlerësim i rezultateve në punë”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 dhe 1.3 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 28.04.2023, mori këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.422/2023 e datës 27.02.2023 e parashtruar nga ankuesi
- II. Ndryshohet Formulari për Vlerësimin e Rezultateve në Punë i datës 31.01.2023 lidhur me notën e përgjithshme të vlerësimit për ankuesin dhe atë nga dy pikë katërdhjetë e dy (2.42) “kënaqshëm ose mjaftueshëm”, bëhet dy pikë pesë (2.5), “mirë”.
- III. Ky vendim zëvendëson Formularin e Vlerësimit të Rezultateve në Punë për ankuesin si në pikën II të dispozitivit dhe i njëjti duhet të përfshihet në dosjen personale dhe regjistrat përkatës të nëpunësit civil.
- IV. OBLIGOHET Udhëheqësi i Njësisë së Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Brendshme që të ndërmerr të gjitha veprimet e nevojshme administrative për zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të tij.
- V. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

Arsyetim

Ankuesi, sipas shkresave të lëndës është i punësuar në pozitën “Zyrtar i Lartë për Standardizim, Trajnim dhe Licencim” në Ministrinë e Punëve të Brendshme, i pa kënaqur me vlerësimin e rezultateve në punë, më datë 27.02.2023 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës, e cila është protokolluar me numër:2124/2023 nën shenjë A.nr.422/2023, kundër Formularit për Vlerësimin e Punës të datës 31.01.2023.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshill me pretendon se së vlerësimi i bërë nga udhëheqësi i tij i drejtpërdrejt është në kundërshtim me gjendjen faktike dhe Rregulloren Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimit Publik, dhe se i njëjti kërkon nga Këshilli që lënda të kthehet në rivlerësim.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës ka proceduar kërkesën e datës 06.03.2023 për përgjigje në ankesën e ankueses në Ministrinë e Punëve të Brendshme, ndërsa kjo e fundit me datë 23.03.2023 ka përcjellë dokumentacionin e kërkuar me shkresat e bashkangjitura të lëndës, ndërsa sipas kërkesës të Kryetarit të Kolegjit, me datë 12.04.2023 Kryetari i Këshillit ka nxjerrë Vendimin me shifër VK/2023 përmes të cilit, ankesës së ankuesit i ka shtyrë afatin e vendimmarrjes edhe për dhjetë (10) ditë pune.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën e ankueses të datës 27.02.2023 me Nr.Prot:2124/2023 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; E-mail i dërguar nga A.R drejtuar L.K e datës 18.01.2022; E-mail i dërguar nga A.R drejtuar L.K e datës 24.01.2022; E-mail i dërguar nga V.M drejtuar L.K e datës 08.02.2022; E-mail i dërguar nga A.R drejtuar L.K e datës 24.03.2022; E-mail i dërguar nga L.K drejtuar A.R e datës 07.03.2022; E-mail i dërguar nga L.K drejtuar A.R e datës 25.03.2023; E-mail i dërguar nga L.K drejtuar A.R e datës 31.03.2022; E-mail i dërguar nga L.K drejtuar A.R e datës 13.05.2022; E-mail i dërguar nga A.R drejtuar L.K e datës 04.07.2022; E-mail i dërguar nga L.K drejtuar A.R e datës 14.07.2022; E-mail i dërguar nga L.K drejtuar A.R e datës 02.08.2022; E-mail i dërguar nga A.R drejtuar L.K e datës 04.08.2022; E-mail i dërguar nga L.K drejtuar A.R e datës 16.08.2022; E-mail i dërguar nga A.R drejtuar L.K e datës 12.08.2022; E-mail i dërguar nga L.K drejtuar A.R e datës 29.09.2022; E-mail i dërguar nga A.R drejtuar L.K e datës 14.10.2022; Ndërrpreja e raportit ditor e datës 10.11.2022; Përgjigja e e-mailit të datës 12.08.2022; E-mail i dërguar nga A.R drejtuar L.K e datës 22.12.2022 për planin e punës për vitin 2022; Raport i punës për vitin 2022 i datës 04.01.2023; E-mail i dërguar nga L.K drejtuar A.R e datës 19.01.2023; Problem me statistika i dërguar me datën 06.02.2023; Njoftimi për vlerësimin për takimin e datës 31.01.2023; Vlerësimi i datës 31.01.2023; Përshkrimi i detyrave të punës i datës 12.06.2015; Raporti i punës për vitin 2022; E-mail i dërguar nga Rims MPB drejtuar L.K e datës 31.01.2023; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë e datës 31.01.2023; Plani Vjetor i datës 18.01.2022; Plani i punës për Divizionin për Shërbime Private të Sigurisë -2022 i datës 24.03.2022; Vendimi i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës A.nr.88/2022 i datës 15.03.2022; E-mail i dërguar nga L.K drejtuar A.R e datës 04.01.2023; Raporti i Punës për periudhën kohore 29.09.2022 deri 09.11.2022; E-mail i dërguar nga L.K drejtuar A.R e datës 30.09.2022; E-mail i dërguar nga L.K drejtuar A.R e datës 19.01.2023; Procesverbal i datës 23.12.2022 i orës 13:00; Procesverbal i datës 23.12.2022 i orës 14:30; E-mail i dërguar nga A.R drejtuar L.K e datës 13.10.2022; E-mail i dërguar nga A.H drejtuar

L.K e datës 12.04.2022; E-mail i dërguar nga A.R drejtuar L.K e datës 18.05.2022; E-mailin i dërguar nga L.K drejtuar F.T e datës 05.04.2022 me korrespondencën e bashkangjitur; E-mail i dërguar nga L.K drejtuar M.H e datës 04.10.2022; E-mail i dërguar nga L.K drejtuar F.T e datës 30.09.2022; E-mail i dërguar nga Rims MPB drejtuar L.K e datës 27.12.2022; Kërkesa për përgjigje në ankesë e datës 06.03.2023; Përgjigje në ankesë e datës 23.03.2023; Ndryshimi i akt emërimit i datës 06.02.2017; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë e datës 09.02.2022; Lista e zyrtarëve për të cilët është rekomanduar trajnim për periudhën kohore 01.01.2021 deri 31.12.2021.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vendosjen e kësaj çështje ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët në procedurë dhe ka konstatuar se ekziston baza ligjore dhe faktike që ankesa e ankuesit është e bazuar, sepse:

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në bazë të shkresave të lëndës ka konstatuar se ankuesi sipas ndryshimit dhe plotësimit të aktit të emërimit të datës 06.02.2017 është transferuar në pozitën "Zyrtar i Lartë për Standardizim, Trajnim dhe Licencim" në Departamentin për Siguri Publike në Ministrinë e Punëve të Brendshme", ndërsa udhëheqësi i tij i drejtpërdrejtë përmes Formularit të Vlerësimit të Rezultateve në Punë të datës 31.01.2023 ankuesin e ka vlerësuar me notën e përgjithshme mesatare dy pikë katërdhjetë e dy (2.42), mirëpo i njëjti kishte shpreh kundërshtimin lidhur me vlerësimin e rezultateve në punë duke bërë kërkesë për rivlerësim, për të cilën kërkesë nuk ka marrë përgjigje.

Me qëllim të vlerësimit të ligjshmërisë së pretendimeve ankimore të ankuesit se vlerësimi i rezultateve në punë për vitin 2022 nga Udhëheqësi i tij i Drejtpërdrejtë është bërë në kundërshtim me dispozitat e Rregullores Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimit Publik, në kërkesën për përgjigje në ankesën e protokolluar me numër:2409/2023 të datës 06.03.2023, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ndër të tjera, ka kërkuar: *Dëshmi me shkrim nëse ndonjëherë gjatë vitit 2022 udhëheqësi i ankuesit ka kërkuar performancë më të mirë, evitim të lëshimeve apo sygjërim në arritjen e objektivave*", ndërsa Ministria e Punëve të Brendshme përmes shkresës së datës 23.03.2023 ka kthyer përgjigje, mirëpo nuk ka arritur të dëshmojë me fakte se gjatë vitit 2022 udhëheqësi i ankuesit ka kërkuar performancë më të mirë, evitim të lëshimeve apo sygjërim në arritjen e objektivave andaj Kolegji i Këshillit ka konstatuar se udhëheqësi i ankuesit nuk i ka përmbushur obligimet mbikëqyrëse siç përcaktohet me nenin 7 të Rregullores Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimit Publik ku përcaktohet se: *"Mbikëqyrësi, së paku një herë gjatë periudhës vlerësuese dhe/ose sa herë që vlerëson të nevojshme, zhvillon takime me nëpunësin për të rishikuar progresin e bërë në arritjen e objektivave të përcaktuara dhe sjelljet profesionale si dhe për dhënien e sugjerime për përmirësim të nevojshme"*.

Kolegji i Këshillit ka analizuar formularin e vlerësimit të rezultateve në punë të ankuesit për vitin 2022 i datës 31.01.2023 dhe ka gjetur se udhëheqësi i drejtpërdrejtë nuk ka vepruar në pajtueshmëri me nenin 8 paragrafi 4 i ku përcaktohet se: *"Formulari i vlerësimit siç përcaktohet në paragrafin 3 të këtij neni i dërgohet nëpunësit, i cili diskutohet në një takim me mbikëqyrësin dhe në afat prej 5 dite kalendarike nëpunësi duhet të shprehet (pajtohet ose nuk pajtohet) me vlerësimin e mbikëqyrësit"*, pasi që Udhëheqësi i Drejtpërdrejtë i ankuesit nuk ka arritur ta dëshmojë se ka vepruar në këtë mënyrë duke e njoftuar ankuesin me vlerësimin të paktën 5 ditë përpara se të përfundojë afati i fundit për vlerësim që sipas nenit 8 paragrafi 2 i së njëjtës rregullore është e përcaktuar: *"Periudha e vlerësimit zgjat 1 vit dhe fillon*

nga 1 janari dhe mbaron më 31 dhjetor. Vlerësimi bëhet deri më 31 janar të vitit të ardhshëm, për vitin paraprak”.

Me qëllim të shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankuesit sa i përket notës së përgjithshme të vlerësimit, Kolegji i Këshillit ka analizuar dispozitat e Rregullores Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimit Publik nënin 11 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 ku përcaktohet se: “Objektivat dhe sjelljet profesionale do të vlerësohen me nota nga 1 deri në 5. Rezultati përfundimtar i vlerësimit llogaritet në bazë të mesatares së marrë dhe paraqitur si në vijim: nga 1.5 deri më pak se 2.5 nënkupton “kënaqshëm ose mjaftueshëm”; nga 2.5 deri më pak se 3.5 nënkupton “mirë”, dhe ndërlidhur me paragrafin 2 nën paragrafin 2.3 dhe 2.4 i të njëjtit nen dhe rregullore ku përcaktohet se: “Kuptimi i notave si në paragrafin 1 të këtij neni është si në vijim: “mirë”, vlerësohet nëpunësi, i cili ka realizuar të gjitha objektivat e punës, dhe ka treguar aftësi të pritshme të punës” ndërsa “kënaqshëm ose mjaftueshëm”, vlerësohet nëpunësi, i cili ka realizuar vetëm disa nga objektivat e punës dhe ka treguar aftësi nën pritjet. Kontributi i tij nuk ka ndikuar, ose ka ndikuar vetëm pjesërisht në realizimin e objektivave dhe performancën e përgjithshme të institucionit”, prandaj marrë për bazë Formularin për Vlerësimin e Rezultateve në Punë për ankuesin i datës 31.01.2023 përmes të cilit ankuesi ishte vlerësuar me notë të përgjithshme mesatare dy pikë katërdhjetë e dy (2.42), Kolegji i Këshillit arrin në përfundimin se për shkak të shkeljeve procedurale dhe materiale nga udhëheqësi i drejtpërdrejtë i ankuesit sikurse është pasqyruar në arsyetimin e këtij vendimi, si dhe duke vlerësuar faktin se ankuesi në vlerësimin paraprak sipas Formularit të vlerësimit të rezultateve të punës për vitin 2021 i datës 09.02.2022 ka qenë e vlerësuar me notë të përgjithshme mesatare 2.99, prandaj në mbështetje të nenit 13 paragrafi 4 të Rregullores Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimit Publik ku përcaktohet se: “Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil pas pranimit të ankesës, në afatin ligjor, vendos duke miratuar apo ndryshuar vlerësimin e mbikëqyrësit (vlerësuesit)”, e ndryshon formularin e vlerësimit të rezultateve të punës së ankuesit, duke vendosur që nota e vlerësimit të rezultateve në punë për ankuesin për vitin 2022 të jetë dy pikë pesë (2.5) apo “mirë” sikurse në dispozitiv të këtij vendimi, ngase sipas materialeve të bashkangjitur me rastin e parashtrimit të ankesës në Këshill ankuesi ka argumentuar mjaftueshëm me prova materiale se ka realizuar objektivat e punës sikurse janë përmbledhur në raportin e tij të punës për vitin 2022 të datës 04.01.2023 dhe e-maileve të dërguara të udhëheqësi i tij me datë 04.04.2022, 16.08.2022, 21.12.2022, 22.12.2022, nga rrjedh si i njëjti ka treguar aftësi të pritshme të punës, shtuar faktin kësaj se gjatë periudhës së vlerësimit në kuptim të nenit 7 të Rregullores Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimit Publik ku përcaktohet se: “Mbikëqyrësi, së paku një herë gjatë periudhës vlerësuese dhe/ose sa herë që vlerëson të nevojshme, zhvillon takime me nëpunësin për të rishikuar progresin e bërë në arritjen e objektivave të përcaktuara dhe sjelljet profesionale si dhe për dhënien e sugjerime për përmirësime të nevojshme”, mbikëqyrësi nuk i kishte tërhequr vërejtjen apo sugjeruar të njëjtin përgjithësi të performancës, nga lënë të kuptojë se në vlerësimin e ankuesit është krijuar përshtypje se veprimet e tij janë në frymën e arritjes së objektivave të punës, për aq kohë sa nga udhëheqësi nuk ka pranuar vërejtje të tilla, andaj mbi këtë bazë si dhe provave të ofruara nga ankuesi, Kolegji i Këshillit vendosi që ankesën e ankuesit të datës 27.02.2023 ta aprovojë si të bazuar.

Tutje, Kolegji i Këshillit thekson faktin se me qëllim të zbatimit të këtij vendimi, Njësia e Burimeve Njerëzore është e obliguar vendimin e Këshillit A.nr.422/2023 të datës 28.04.2023 ta vendos në dosjen personale të ankuesit sipas përgjegjësisë funksionale që ka në kuptim të dispozitave të ligjit material.

Andaj, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 dhe 1.3 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë–Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.422/2023

Flakron GASHI

Procesmbajtës

Eshref SHABANI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Punëve të Brendshme;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Brendshme, dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.